



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 455/4 Prot

Tiranë, më 01.07.2021

**V E N D I M**

Nr.90, datë 01.07.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të lirimt nga shërbimi civil të nëpunëses civile \*\*\*\*\* , për shkak të ristrukturimit të institucionit.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të përcjellë nga nëpunësja \*\*\*\*\* , për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së veprimit administrativ të lirimt nga detyra, për shkak ristrukturimi të institucionit,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet kërkesës nr. 455 prot., datë 07.04.2021, nëpunësja \*\*\*\*\* ka ngritur disa pretendime, për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së veprimit administrativ të lirimt nga detyra, për shkak ristrukturimi të institucionit.

Nga verifikimi i kryer për këtë rast, rezulton se nëpunësja \*\*\*\*\* , pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 69, datë 16.12.2019, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist jurist” (kategoria e pagës IV-a) pranë Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKK). Pas kryerjes me sukses të periudhës së provës, ajo është vlerësuar pozitivisht dhe konfirmuar nga eprori direkt e mbi

këtë bazë, me aktin nr. 15/1 prot., datë 12.02.2021 “*Akti i deklarimit të statusit të nëpunësit civil*”, të njësisë përgjegjëse, është përmyllur procesi, duke u deklaruar nëpunëse civile.

Kjo marrëdhënie punësimi ka vijuar deri në momentin e ristrukturimit të institucionit, kur njësisë përgjegjëse, në kuadër të implementimit të strukturës së re të institucionit, miratuar me vendimin nr. 11/2021, të Kuvendit të Shqipërisë “*Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimin e pozicioneve të punës në Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunitetit në Shqipëri*”, me aktin nr. 14/29 prot., datë 24.03.2021, është deklaruar përfundimi i marrëdhënies së saj, në shërbimin civil.

Kjo e fundit, kundërshton aktin e lirimit të saj nga shërbimi civil, me pretendimin që ai është i paligjshëm pasi ka dalë gjatë fushatës zgjedhore ndërkohë që ligji e ndalon rreptësisht dhe veç kësaj, ekzistonin mundësitë që ajo të sistemohej në një nga pozicionet e krijuara pas ristrukturimit, qoftë edhe përkohësisht.

Nga përmbajtja e vendimit të këtij komisioni, nuk del qartë se cilat janë përpjekjet e bëra për ta sistemuar nëpunësen në një nga pozicionet e lira dhe nuk ka një arsytim bindës të bazuar në ligj e në fakte. Për më tepër, nuk rezulton të jetë bërë ndonjë përpjekje për bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, apo me institucione të tjera, për mundësinë e sistemimit të saj në ndonjë nga pozicionet e lira në sistemin e shërbimit civil, të përshtatshme me nivelin e saj të kualifikimit.

Megjithatë, meqënëse, gjatë vazhdimit të hetimit administrativ, për vlerësimin e ligjshmërisë të këtij rasti, u konstatua se nëpunësja \*\*\*\*\*, i është drejtuar organeve gjyqësore, bazuar në nenin 36, të Kodit të Procedurave Civile, sipas të cilit, asnjë organ administrativ nuk mund të vendosë, për një çështje që është duke u trajtuar dhe pritet të shprehet sistemi gjyqësor, ka vend për të përfunduar shqyrtimin dhe arkivimin e çështjes.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në nenin 95, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr.14/29 prot., datë 24.03.2021, të lirimit nga shërbimi civil për shkak ristrukturimi,

të nëpunëses \*\*\*\*\* dhe meqënëse çështja është duke u trajtuar nga organet gjyqësore, arkivimin e saj.

2. Të njoftohet për këtë vendim Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, si dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**